

Vendim nr. 7 datë 15.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 15.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 22 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: KUJTIM LULI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 42, datë 06.10.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 319, datë 03.12.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Përfundimi i procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për çështjen për shkak se objekti dhe qëllimi atij procesi është bërë i pamundur.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 42, 131, pika 1, shkronja “ç”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 3, pika 16 e vijues, të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve” (*ligji nr. 84/2016*); neni 64, pikat 1, shkronja “c” dhe 5, të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kujtim Luli ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, për rrjedhojë ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas parashikimeve të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*KPK*), me vendimin nr. 319, datë 03.12.2020, ka vendosur konfirmimin e kërkuesit në detyrë, me arsyetimin se ai, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, me veprimet apo mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë dhe figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

3. Në datën 24.02.2021 Komisioneri Publik ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (*KPA*), duke kërkuar ndryshimin e vendimit të *KPK*-së dhe shkarkimin e kërkuesit nga detyra, me argumentet se për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, ai dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë së plotësimit të mangësive nëpërmjet programit trajnues, në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

4. *KPA*-ja në datën 25.07.2023 ka çelur procesin e shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik. Në seancën gjyqësore të datës 26.09.2023 *KPA*-ja, pasi dëgjoji konkluzionet përfundimtare të palëve ka vendosur të tërhiqet për marrjen e vendimit përfundimtar, të cilin do ta shpallte në datën 06.10.2023.

5. Kërkuesi në datën 02.10.2023 i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*) me kërkesë për ndërprerjen e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë. Në vijim, *KLP*-ja, me vendimin nr. 314, datë 05.10.2023, ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për këtë shkak. Vendimi ka marrë formë të prerë dhe kërkuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare në datën 05.10.2023.

6. Me kërkesën e datës 05.10.2023, kërkuesi i është drejtuar KPA-së, duke kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si të përfunduar sipas parashikimeve të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk gëzonte më statusin e magjistratit prokuror, rrjedhimisht objekti për të cilin ishte nisur procedura e rivlerësimit ka rënë.

7. KPA-ja në datën 06.10.2023 ka shpallur publikisht vendimin për ndryshimin e vendimit nr. 319, datë 03.12.2020 të KPK-së dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se ai nuk arrinte nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për rrjedhojë vendimi i KPK-së për konfirmimin në detyrë nuk ishte i bazuar në fakte dhe ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohej. Gjatë shpalljes së vendimit, KPA-ja ka bërë me dije se vendimi për kërkuesin ishte marrë në datën 03.10.2023 dhe ishte caktuar të shpallej në datën 06.10.2023. Sipas kërkuesit, vendimi i arsyetuar i është njoftuar në datën 06.08.2024.

8. Në datën 03.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit të KPA-së, sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi** ka pretenduar cenimin e të drejtave kushtetuese nga KPA-ja, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi ajo nuk kishte juridiksion dhe kompetencë për vendimmarrje, sepse objekti për të cilin kishte nisur procedura dhe qëllimi i procesit për të ishin bërë të pamundur, për shkak se ai nuk gëzonte statusin e magjistratit si pasojë e mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë. Kryesuesja e trupit gjykues të KPA-së, në seancën e datës 06.10.2023, ka shpallur vendimin për procesin e rivlerësimit, i cili ishte marrë, sipas saj, në datën 03.10.2023. Sipas KPA-së, në kushtet kur vendimi i KLP-së dhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit janë depozituar në datën 05.10.2023, pas datës së marrjes së vendimit nga trupi gjykues i Kolegjit, ato janë konsideruar absolutisht të papranueshme, për shkak të paraqitjes jashtë afatit procedural. Vendimmarrja e datës 03.10.2023 nuk është bërë e njohur publikisht dhe nuk i është komunikuar as kërkuesit, as KLP-së, në shkelje të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16, të ligjit nr. 84/2016. Momenti ligjor i marrjes së vendimit dhe shpalljes së tij duhet të ishte data e njoftuar 06.10.2023 dhe jo data 03.10.2023. KPA-ja, ndryshe nga praktikat e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, ka pasqyruar në vendim dy data të ndryshme, për marrjen dhe shpalljen

e vendimit. Ndonëse, KPA-ja i ka administruar në dosje dokumentet për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, së bashku me aktet e tjera të relatuara në seancë dhe i ka pasqyruar në procesverbal, ajo nuk i ka trajtuar ato në vendimin e saj nr. 42, datë 06.10.2023. Sipas kërkesit, KPA-ja ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë deri në atë masë që arrin mohim flagrant të drejtësisë.

- 9.2. *Së drejtës për jetë private*, të garantuar nga neni 36 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së, pasi shkarkimi nga detyra i papritur, i paligjshëm dhe arbitrarisht përbën ndërhyrje në jetën private të panevojshme, haptazi joproporcionale dhe që prek një gamë të gjerë të marrëdhënieve me persona të tjerë, përfshirë marrëdhëniet e natyrës profesionale.
- 9.3. *Barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së, pasi KPA-ja ka përdorur standard të dyfishtë në raport me raste të tjera të ngjashme, në të cilat në dhomën e këshillimit ka administruar provat e reja dhe ka pranuar kërkesat e subjekteve të rivlerësimit. Konkretisht, në çështjet nr. 10 (JR), datë 05.03.2024, nr. 22 (JR), datë 14.05.2024 dhe nr. 30 (JR), datë 01.07.2024, për të njëjtin shkak, ka vendosur përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin përkatës pa një vendim përfundimtar, sepse objekti dhe qëllimi i atij procesi ishin bërë të pamundur. Për më tepër, këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPK-ja në vendimin nr. 119, datë 21.03.2019.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

10. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Kjo kompetencë kushtetuese e Gjykatës është reflektuar dhe detajuar në nenin 71 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës çdo akt që cenon këto të drejta dhe liri, sipas kriterëve kumulative të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji. Në këndvështrim të kësaj kompetence, Gjykata vlerëson kërkesat e individit kur ai pretendon se të

drejtat dhe liritë themelore kushtetuese janë cenuar nga një akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor.

11. Kolegji vëren se, referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata funksionon me dy kolegje. Neni F, pika 1, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se KPA-ja është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të KPK-së, sipas Aneksit dhe ligjit. Kurse juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për kontrollin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit është i kufizuar nga juridiksioni që dispozitat e Kushtetutës dhe Aneksit të saj u kanë dhënë organeve të rivlerësimit (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Neni 179/b, pika 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Në këtë kuptim, të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe standardin e “gjykatës së krijuar me ligj”, Kushtetuta ua ka garantuar subjekteve të rivlerësimit përmes procesit gjyqësor në KPA. Duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së, si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, Gjykata ka vlerësuar se ky proces kontrollon edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në kontekst të sa më sipër, për sa i takon shqyrtimit të kërkesave që kundërshtojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, Kolegji thekson se juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për këto çështje është i kufizuar nga vetë Kushtetuta, ndaj pretendimet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e këtyre organeve, qofshin të natyrës kushtetuese, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Subjektet e rivlerësimit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, për pretendime ose kërkesa që i përkasin atij procesi, i cili, siç vlerëson edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka natyrë përfundimtare brenda sistemit të brendshëm të ankimeve.

15. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues për sa kohë që objekti i kërimit është rishikimi i vendimit të organeve të tjera kushtetuese, sikurse ai i KPA-së në rastin e kërkuarit Kujtim Luli.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.